



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr.139 Datë 24 . 02 . 2010

Mbi

Autorizimin e përqendrimit për përfitim të plotë të kontrollit nga Procter & Gamble Group, në Sara Lee Group, realizuar nëpërmjet blerjes së 100% aseteve të shoqërisë target Sara Lee Air Care.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- | | |
|----------------------------|---------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| ▪ Zt. Koço Broka | Anëtar |
| ▪ Znj. Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 24.02 .2010, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit për përfitim të plotë të kontrollit nga Procter & Gamble Group, në Sara Lee Group, realizuar nëpërmjet blerjes së aseteve të biznesit ndërkombëtar të kompanisë target Sara Lee Air Care.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53-56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Mbi formën e njoftimit të përqendrimit”; Aneksi I- Formulari i thjeshtuar i njoftimit

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit dhe Relacionit të Sekretares së Përgjithshme bashkëlidhur këtij raporti

V Ë R E N S E:

Palët:

Procter & Gamble Group, në cilësinë e blerësit, me seli në Ohajo, SHBA, nëpërmjet filialeve të saj ushtron veprimtari brenda dhe jashtë SHBA-së për prodhimin e produkteve të kujdesit shtëpiak, të bukurisë, të shëndetit, si dhe të produkteve për bebet dhe familjen.

Sara Lee Corporation, në cilësinë e shitësit, me seli në Illinois, SHBA, ushtron veprimtarinë e saj në prodhimin dhe tregtimin e produkteve të markuara për konsumatorët në të gjithë botën, të përqendruara kryesisht në kategoritë e mishit, brumrave, pijeve, mirëmbajtjes shtëpiake dhe kujdesit për trupin.

Shoqëria Sara Lee Air Care, objektivi i operacionit (target), me seli në Illinois, USA, ushtron veprimtarinë e saj në tregun ndërkombëtar të prodhimit dhe tregimit të produkteve të aromatizuesave të ajrit nën markën Ambi Pur.

Përqendrimi

Transaksioni përfshin blerjen 100% të veprimtarisë ekonomike (biznesit) të Sara Lee Air Care, për prodhimin dhe tregtimin ndërkombëtar të produkteve të aromatizuesave të ajrit nën markën Ambi Pur.

Ky transaksion është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të blerësit (P&G) për zgjerimin e tregut të prodhimit dhe tregimit të aromatizuesave, ku veprimtaria e tij është e kufizuar vetëm në aromatizuesin e tekstileve të markës “Febreze”.

Xhiro për vitin 2009

Përqendrimi i njoftuar është objekt i autorizimit të Komisionit të Konkurrencës pasi plotëson kriteret e xhiros në kuptim të nenit 12, pika 1.

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është xxxxx miliardë lekë
- Xhiro totale **në tregun e brendshëm** është xxxxx miliard lekë

Tregu Përkatës:

- Tregu i produktit: Aromatizuesit e ajrit, që përfshijnë këto nëntregje:

- Aromatizuesh shtëpish
- Aromatizues makinash
- Aromatizues banjosh; dhe
- Aromatizues tekstilësh

Tregu gjeografik: Teritorri i Republikës së Shqipërisë.

Tregje të prekura: Produktet, të cilat prodhohen dhe tregtohen nga të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në përqendrim dhe që i përkasin të njëjtit grup

(aromatizuesish) nuk kanë të njëjtin qëllim përdorimi, pra nuk janë produkte të zëvendësueshme ose të shkëmbyeshme.

Si konkluzion,

Transaksioni i njoftuar që konsiston në përfitim të kontrollit ndërmjet Procter & Gamble dhe Sara Lee Corporation, me objektin blerjen 100 % të aseteve të prodhimit, shpërndarjes dhe tregimit të produkteve të aromatizuesave në Sara Lee Air Care, nuk të çon në ndryshim strukturë, mbivendosje të pjesëve të tregut apo rritje të pjesëve të tij, sepse ndërmarrjet pjesëmarrëse veprojnë në tregje të ndryshme të produktit. Nuk ka lidhje shkakësore midis realizimit të këtij përqendrimi dhe krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun e brendshëm për ndërmarrjet objekt përqendrimi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, shkronjat d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar për përfitim të kontrollit nga Procter & Gamble Group, në Sara Lee Group, realizuar nëpërmjet blerjes së 100% aseteve të shoqërisë target Sara Lee Air Care.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E